



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 /2008, nenin 3, 4, 5 dhe 6 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 41.2, "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më **14 janar 2022**, merr këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIM TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

1. Me këtë vendim themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa nga radhët e anëtarëve të kuvendit të komunës, në këtë përbërje:

- 1.1 **Melihate Basholli Latifi, – Kryesuese e KPF nga radhët e PDK;**
- 1.2 **Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së nga radhët e PDK-së;**
- 1.3 **Lorik Maxhuni, anëtar i KPF-së nga radhët e PDK-së;**
- 1.4 **Nurie Halili, anëtare e KPF-së nga radhët e PDK-së;**
- 1.5 **Agron Përçuku, anëtar i KPF-së nga radhët e LDK-së;**
- 1.6 **Alban Bajrmai, anëtar i KPF-së nga radhët e LDK-së;**
- 1.7 **Fakete Dushi, anëtare e KPF-së nga radhët e LDK-së;**
- 1.8 **Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së nga radhët e LVV-së dhe**
- 1.9 **Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së nga radhët e LVV-së;**

2. Komiteti për Politikë dhe Financa, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtroj në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Themelimit Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera Komunë, Statutin e komunës, akteve tjera si dhe rregulloren e punës.

3. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa është i njëjte me mandatin e anëtarëve të kuvendit të komunës përveç nëse ky mandat i pushon në rastet e parapara me legjislacionin në fuqi.

4. Anëtarët e KPF-së, për pjesëmarrje në mbledhje do të kompensohen sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.

5. Ky vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

